

Emërtimi i programit të studimit	LL.M. E Drejta Civile dhe Biznesore
Grada shkencore:	Master i Drejtësisë - LLM E Drejta Civile dhe Biznesore
Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve:	Niveli shtatë -VII- sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK-së)
Kohëzgjatja minimale e studimeve dhe numri i ECTS kredive:	Studime vjeçar (1) vjeçare; 60 ECTS kredi
Misioni i Programit:	Misioni i Programit E Drejta Civile dhe Biznesore, është kontribujë në studimin e avancuar të së drejtës civile dhe të drejtës biznesore në veçanti, duke u fokusuar në kërkimet ligjore të cilat do t'i përgjigjen ndryshimeve strukturore në të drejtën private, të drejtën e biznesit dhe sfidave dhe nevojave sociale në mjedisin e ri juridik. Përmes këtij Programi, do të mundësohet përgatitja e juristëve me njohuri shkencore dhe shkathtësi praktike për të drejtësinë civile dhe biznesore, në mënyrë që të diplomuarit të jenë të gatshëm të shërbejnë me profesionalizëm në sistemin juridik, por edhe sektorin privat, në nivelin nacional dhe ndërkombëtar.
Qëllimi i programit të studimit:	Programi i studimit E Drejta civile dhe biznesore LLM ka për qëllim aftësimin dhe përgatitjen e juristëve në një fushë të specializuar siç është e drejta civile dhe biznesore, duke iu ofruar njohuri, përvoja dhe zhvillim të aftësive analitike, teorike dhe praktike dhe shkathtësive të domosdoshme për ushtrimin e profesionit të juristit të së drejtës civile dhe biznesore në praktikë. Programi ka për qëllim përgatitjen e juristëve që në jetën e tyre profesionale, menaxheriale dhe udhëheqëse t'i përballojnë sfidat që do t'u paraqiten si profesionist të shkencës së të drejtës civile dhe biznesore. Programi përgatit juristë të gatshëm për tu përballur me sfidat e ekonomisë së tregut të lirë në botën dinamike të zhvillimit të marrëdhënieve shoqërore.
Objektivat programit:	Objektivat e këtij programi janë: • T'i realizojë aspiratat e juristëve që profesionalizohen në një fushë specifike të studimit të drejtësisë, siç është E Drejta Civile dhe Biznesore; • Tu mundësojë zhvillimin akademik juristëve në fushën e të Drejtës Civile dhe Biznesore; • Të ofrojë njohuri dhe shkathtësi të avancuara të parimeve themelore shkencore dhe legjislacionit të së drejtës civile dhe biznesore të Republikës së Kosovës; • Të ofrojë shkathtësi për dhe mënyrës së funksionimit të së drejtës biznesore në kontekst ndërkombëtar; • Të zhvillojë një kritikë të ndërgjegjshme të së drejtës në kontekstin komparativ, socio-ekonomik

	dhe t'u ofrojë studentëve një varg konceptesh të ndryshme teorike të ndërlidhura me studimet juridike civile; T'u mundësojë studentëve të jenë pjesë e veprimtarisë hulumtuese në kuadër të studimeve të tyre
Rezultatet e pritshme të mësimi:	1. Njohuri dhe të kuptuarit: • Të demonstrojnë një kuptim të avancuar të aspekteve të ligjit që ndikojnë në biznes dhe praktika; • Të fitojë njohuri të avancuara rreth statusit juridik të shoqërive tregtare; • Të fitojë njohuri të avancuara për kontratat komerciale; • Njohuri për funksionimin e arbitrazhit tregtar ndërkombëtar • Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet aktuale që ndikojnë në mjedisin e biznesit dhe kuadrin ligjor në fuqi; • Të tregojnë aftësi të të kuptuarit e fushëveprimit të ligjit të biznesit dhe rëndësinë e zbatimit të qeverisjes korporatave 2. Aftësi dhe shkathtësi: • Të analizojë dhe zbatojë arsyetimin ligjor për të zgjidhur çështjet e kontekstit të biznesit; • Të argumentojë zbatimin e parimeve dhe politikave ligjore dhe të bëjnë vlerësime kritike rreth zbatimit të legjislacionit civil dhe biznesor; • Të ofrojnë shërbime profesionale rreth regjistrimit të bizneseve; • Të përgatisin shkresa juridike në fushën e biznesit; • Ruajtja e vlerave etike dhe profesionale në ushtrimin e profesionit të juristit në praktikë. 3. Shkathtësi praktike / kompetenca: • Të shpjegojë qëllimin dhe funksionin e ligjit të procedurës civile dhe strukturën e gjykatës civile dhe asaj komerciale dhe detyrat e profesionistëve që punojnë në gjykata; • Të shpjegojë kompetencën dhe juridiksionin e gjykatave civile dhe komerciale; • Të jenë në gjendje të përfaqësojnë biznese para arbitrazhit vendor dhe ndërkombëtar; • Shkrimi i një Hulumtimi Shkencor që përcjell gjetjet e hulumtimit juridik në një formë bindëse në fushën e së drejtës civile dhe të biznesit.
Mësimdhënia dhe mësim nxënia:	Forma tradicionale e mësimdhënies në

	Fakultet shpesh përfshin leksione për grupe të mëdha studentësh, shoqëruar me orë mësimore dhe seminare, me disa studime të pavarura. Sidoqoftë, ka disa metoda të tjera mësimore që do të zbatohen gjithashtu në këtë program dhe janë provuar të jenë shumë efektive në universitetet e tjera, të tilla si të mësuarit e përzier dhe të mësuarit me bazë problemesh, dhe të tjera si më poshtë: • "Klasë e Kthyer" do të konsiderohet një qasje e "kthyer" duke u kërkuar studentëve të shikojnë video përmbajtje para leksioneve dhe t'i kushtojnë kohë ushtrimeve, projekteve dhe diskutimeve në klasë; • Të mësuarit aktiv duke eksploruar metodat e mësimdhënies dhe të të nxënit që e bëjnë studentin përgjegjës për mësimin e tij përmes aktiviteteve kuptimplota. • Të mësuarit bazuar në problemet ku studentët janë në qendër të vëmendjes dhe mësojnë rreth një teme përmes të kuptuarit dhe zgjidhjes së problemeve (raste praktike); • Të mësuarit në bazë të punës që u siguron studentëve të mësojnë përmes përvojave të punës në jetën reale. • Të mësuarit e përzier që ndërthur mësimin tradicional në klasë me mësimin në internet dhe studimin e pavarur. Mësimi i drejtuar nga studentët, ku studentët punojnë së bashku për të mbështetur mësimin e njëri-tjetrit.
Vlerësimi i studentëve:	Mekanizmat e vlerësimit të studentëve që paraqiten në planprogramet e secilës lëndë ofrojnë një vlerësim të drejtë dhe objektiv. Secili profesor është i detyruar të prezantojë planprogramin para studentëve para fillimit të leksioneve me një fokus të veçantë në metodat e vlerësimit. Konsiderohet se kjo strategji e kombinuar e mësimdhënies dhe metodat e vlerësimit të parashikuara në programet mësimore janë të përshtatshme për arritjen e rezultateve të të nxënit të përcaktuara në këtë program dhe ka mjaft fleksibilitet për të përmbushur nevojat e grupeve të ndryshme të studentëve. Monitorimi i sigurimit të cilësisë sigurohet përmes mekanizmave që vlejnë për të gjitha programet tjera të studimit por ka një mekanizëm tjetër shtesë. Në mënyrë që të verifikojë standardet e

	arritjeve të studentëve, udhëheqësi i programit do të zbatojë një mekanizëm të përshtatshëm të jashtëm përmes vizitave të stafit nga universitete të tjera me përvojë në rishikimin e mjeteve të vlerësimit (teston detyrat e studentëve) së bashku me punën shembullore të studentëve dhe notave. Për të realizuar këtë mekanizëm, proceset e duhura do të përdoren brenda një viti dhe për më pak se 50% të kurseve të ofruara nga departamenti.
Kurrikula:	Viti i parë Semestri i parë: O - E Drejta e Pronësisë; O - E Drejta e Shoqërive Tregtare; O – E Drejta Kontraktore dhe Komerciale O - Metodologjia e punës kërkimore - shkencore; Z - E Drejta Biznesore e Bashkimit Evropian; Z - E Drejta e Punës dhe Punësimi; Z - Etika në Biznes; Z - E Drejta për Tregtinë Elektronike Semestri i dytë: O – Gjyqësia Civile dhe Koerciale; O - E Drejta e Pronësisë Industriale; O – Arbitrazhi Tregtar Ndërkombëtar; O – Tema master; Z – Shkathtësisë e Praktikës Gjyqësore; Z – Kriminaliteti Ekonomik; Z – Ndërmarrësia e Gjelbër; Z - E Drejta e Internetit; Z – E Drejta e Telekomunikacionit e BE-së.